

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIII, nr. 6873  
E shtunë, 15 prill 2023  
Çmimi 0.40 €

## Xhaçka takohet me kryediplomatin spanjoll: Duhet angazhim konstruktiv për Kosovën



Na ndiqni edhe në:  
[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

# KOSOVA DHE MALI I ZI NËN SHKRUANJË MARRËVESHJE PËR SHËRBIME AJRORE



Kryeministri Albin Kurti ka pritur të premtën në takim kryeministrin në detyrë të Malit të Zi, Dritan Abazoviq, me të cilin ka nënshkruar marrëveshje për shërbime ajrore në mes të Qeverisë së Kosovës dhe

Qeverisë së Malit të Zi. Kjo marrëveshje është hap i rëndësishëm për rregullimin e hapësirës ajrore mes dy vendeve. Ajo ofron mundësi të reja të zhvillimit të aviacionit civil,

mundëson shkurtimin e rrugëve ajrore të fluturimit për 15 minuta. Një kompani ajrore që ka fluturuar katër herë në ditë, me këtë marrëveshje lehtësisht mund të shtojë edhe një fluturim

## BISLIMI: SHTYRJA E ZGJEDHJEVE NË VERI NUK ËSHTË OPSION I MIRË



## ZGJEDHJET NË VERI, KQZ-ja MIRATON 19 QENDRA TË VOTIMIT, 13 PREJ TYRE ALTERNATIVE



**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
MITROVICË  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## AKTUALE



### NJË MUAJ PARABURGIM PËR TRE TË DYSHUARIT PËR SULMIN NDAJ GAZETARIT SYLA

### MARSH NË PRISHTINË NË MBËSHTETJE TË TË MBIJETUARVE TË DHUNËS SEKSUALE GJATË LUFTËS

### KLINIKA E ENDOKRINOLOGJISË RRIIT PERFORMANCËN E PUNËS

## EKONOMI



### KRM "PASTRIMI" BËHET ME KRYESHEF TË RI

### RUAJTJA E CILËSISË SË LARTË NË AUDITIM, PRIORITET PËR INSTITUCIONET SUPREME TË AUDITIMIT

## SPORT



### DUKAGJINI - DRITA, DERBI I JAVËS NË SUPERLIGËN E FUTBOLL

# Kievi i kërkon NATO-s ta sigurojë Detin e Zi dhe ta integrojë mbrojtjen e Ukrainës

**KIEV, 14 PRILL** - Ministri i Jashtëm i Ukrainës, Dmytro Kuleba, i ka bërë thirrje NATO-s ta luajë një rol më të madh për sigurimin e rajonit të Detit të Zi dhe ta integrojë mbrojtjen ajrore dhe raketore të Ukrainës me ato të anëtarëve të aleancës veriatlantike.

Që kur nisi pushtimi i paprovokuar i Ukrainës nga Rusia në shkurt të vitit të kaluar, Deti i Zi dhe bregu i tij në Ukrainë kanë qenë pikë diskutimi për shkak të rëndësisë së këtyre zonave për luftën. “Deti i Zi është instrumental për ta bërë të gjithë Evropën paqësore dhe për ta orientuar drejt së ardhmes”, tha Kuleba, duke folur përmes videolidhjes në një konferencë për sigurinë në Detin e Zi të mbajtur në Bukuresht. “Mjerisht, ai është një vitrinë që tregon se sa shpejt gjërat mund të përkeqësohen nëse dikush i neglizhon kërcënimet. Është koha për ta shndërruar Detin e Zi në atë që është bërë tani Deti Baltik, një det i NATO-s”, shtoi ai. Këto komente të Kulebas u hodhën poshtë në Moskë, ku zëdhënësi i Kremlinit, Dmitry

Peskov, tha në një konferencë se “Deti i Zi nuk mund të jetë kurrë një det i NATO-s”. “Ky është një det i përbashkët, duhet të jetë një det bashkëpunimi, ndërveprimi dhe sigurie për të gjitha shtetet e tij bregdetare”, shtoi ai.

Si Moskë ashtu edhe Kievi mbështeten në Detin e Zi për tregti. Përmes tij ata bëjnë furnizimin e tregjeve të drithërave si dy nga eksportuesit më të mëdhenj të ushqimit në botë. Një bllokadë ruse ndaj këtyre transporteve rrezikoi të shkaktonte një krizë globale ushqimore vitin e kaluar. Më vonë Kombet e Bashkuara dhe Turqia ndërmjetësuan një marrëveshje për t'i mbajtur portet të hapura, ndërsa aktualisht po punohen për zgjatjen e kësaj marrëveshjeje. “Ne duhet të trajtojmë së bashku problemin e përbashkët të Rosisë”, tha Kuleba. “Për shembull, unë mbështes idenë e ekspertëve për t'i integruar sistemet e mbrojtjes ajrore dhe raketore të Ukrainës me ato të aleatëve të NATO-s në Detin e Zi dhe Baltik”.

Flota ruse e Detit të Zi është e



vendosur në Krime, gadishullin ukrainas që Moskë e aneksoi në vitin 2014. Kapja e porteve të Ukrainës ka qenë një objekt kryesor i Rosisë gjatë luftës që nisi vitin e kaluar. Pas anëtarësimit të Finlandës në NATO dhe aplikimit të Suedisë, Rusia pritet që së shpejti të mbetet i vetmi vend me

dalje në Detin Baltik që nuk është anëtare e NATO-s.

Aplikimet për anëtarësim në NATO nga Ukraina dhe Gjeorgjia do ta krijojnë një situatë të ngjashme edhe në Detin e Zi, ku Bullgaria, Rumania dhe Turqia janë tashmë anëtare të aleancës ushtarake.

Kuleba tha se samiti i ardhshëm i NATO-s do të ishte një mundësi për të ecur përpara në anëtarësimin e shumëkërkuar të Ukrainës në NATO, “për të treguar se dera nuk është vetëm e hapur, por se ka një plan të qartë se kur dhe si do të hyjë Ukraina në të”.

## BE-ja sanksionon Wagnerin për luftën në Ukrainë

**Bruksel, 14 prill** - Bashkimi Evropian bëri me dije të enjten, më 13 prill, se grupi mercenar rus Wagner është futur në listën evropiane të sanksioneve për “pjesëmarrje aktive në luftën e agresionit rus kundër Ukrainës”. Wagner, që po udhëheq betejat ruse në përpjekjet për t'i pushtuar qytetet ukrainase Bahmut dhe Soledar, ishte vendosur në shkurt në një listë tjetër sanksionesh të BE-së për shkelje të të drejtave të njeriut dhe “destabilizimin” e vendeve në Afrikë.

Këshilli Evropian, që përfaqëson 27 vendet anëtare të BE-së, tha se lista e sanksioneve të reja e

“kompleton” atë të mëparshmen. BE-ja shtoi se Wagneri u shtua edhe një herë në listë “për veprime që minojnë ose kërcënojnë integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës”.

Fakti që Wagneri është listuar dy herë “nënvizon dimensionin ndërkombëtar dhe peshën e aktiviteteve të këtij grupi si dhe ndikimin e tij destabilizues në vendet ku ai është aktiv”, thuhet në deklaratën e Këshillit.

Në listën evropiane të sanksioneve u shtua edhe RIA FAN, një media ruse që është pjesë e grupit Patriot Media Group, bordi i së cilës drejtohet



nga Yevgeny Prigozhin, shef i Wagnerit.

Një organizatë joqeveritare ruse dhe një dezertor i Wagnerit kanë pretenduar se luftëtarët e Wagnerit ishin përgjegjës për incidentin e prerjes së kokës të një të burgosuri lufte ukrainas që duket në një video që ka tërhequr vëmendjen e Ukrainës dhe zyrtarëve të OKB-së.

Prigozhin i mohoi akuzat të enjten. Rusia tha se ka hapur një hetim lidhur me këto pamje.

BE-ja ka miratuar dhjetë pako të njëpasnjëshme sanksionesh kundër Rosisë gjatë vitit të kaluar pas pushtimit të paprovokuar të Ukrainës.

## Koreja e Veriut thotë se ka testuar një raketë të re me rreze të gjatë veprimi



**PHENIAN, 14 PRILL** - Koreja e Veriut tha të premten se ka testuar për herë të parë një raketë balistike ndërkontinentale me rreze të gjatë veprimi, që operon përmes lëndëve djegëse të ngurta. Këto lloje raketash janë më të fuqishme dhe më vështirë detektohen. Agjencia Qendrore e Lajmeve Koreane (KCNA) lëshoi njoftimin një ditë pasi fqinjët e Veriut detektuan lëshimin e një raketë me rreze të gjatë veprimi nga afërsia e

Phenjanit.

Që nga fillimi i vitit 2022 Koreja e Veriut ka lëshuar në det mbi 100 raketa.

Testimi i 13 prillit duket se nuk ka treguar të gjithë kapacitetin e armës së re dhe është ende e paqartë se sa larg ka shkuar Koreja e Veriut sa i përket teknologjisë për raketat që mund të bartin koka bërthamore. Megjithatë, analistët kanë thënë se testimi i kësaj raketë paraqet një përparim të rëndësishëm drejt qëllimit të Koresë së

Veriut për ta ndërtuar arsenalin bërthamor që do ta mund të kërcënonte direkt ShBA-në.

KCNA tha se testimi i raketës është mbikëqyruar nga lideri verikorean Kim Jong Un, i cili e përshkroi raketën të emëruar Hwasong-18 - si armën më të fuqishme të forcave të tij bërthamore, që do t'i risë aftësitë kundërsulmuese në dritë të kërcënimeve të jashtme të krijuara nga aktivitetet ushtarake të ShBA-së dhe aleatëve të saj në rajon.

## Bislimi: Shtyrja e zgjedhjeve në veri nuk është opSION i mirë

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 14 PRILL - Zëvendëskryeministri dhe kryenegociatori i Kosovës për bisedimet me Serbinë, Besnik Bislimi, thotë se shtyrja e zgjedhjeve për kryetarët e komunave veriore të banuara me shumicë serbe nuk është opSION i mirë.

Në intervistën për "Zërin e Amerikës" ai ka thënë se shtyrja do të ishte në interes të atyre që mendojnë se veriu në këtë moment duhet të shndërrohet në një zonë të menaxhimit të krizave. "Shtyrja nuk është opSION i mirë. Është opSION i atyre që mendojnë që në këtë moment më mirë është që veriu të shndërrohet në një zonë të menaxhimit të krizave dhe jo të hyjë në një proces të normalizimit të raporteve. Për momentin protagonist kryesor që kërkon shtyrjen e zgjedhjeve është z. Vuçiqi i cili edhe kërkon koncesione për pjesëmarrjen në zgjedhje", ka thënë Bislimi.

Bislimi ka thënë, ndër të tjera, se Kosova dhe Serbia nuk po bien dakord mbi strukturën që duhet të ketë Komiteti i Përbashkët Monitorues për zbatimin e marrëveshjes së Ohrit, ngritja e të cilit duhet të bëhet deri më 18 prill. Ai ka shtuar se i emëruari i Kosovës për drejtimin e Komitetit është ambasadori i Kosovës në Bruksel, Agron Bajrami. Ministri i Punëve të Brendshme i Kosovës, Xhelal Sveçla, ka thënë se është i

bindur që zgjedhjet e jashtëzakonshme në katër komunat në veri të Kosovës do të përfundojnë të suksesshme. Në Mitrovicë të Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok më 23 prill do të mbahen zgjedhjet për kryetar të komunës, ndërkaq zgjedhje për kuvende komunale do të zhvillohen në Leposaviq dhe Zveçan.

Gjatë raportimit para Komisionit Parlamentar për Integrim Evropian, Sveçla ka thënë se Policia e Kosovës dhe e gjithë Ministria e Brendshme janë në dispozicionin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për t'i organizuar votimet. "Për ne është imperativ që këto zgjedhje të mbahen në një atmosferë të qetë, të sigurt, qoftë për organizatorët, por edhe për vetë qytetarët atje. Janë çështje të vendimeve politike të subjekteve të caktuara të cilat duan apo nuk duan të marrin pjesë në zgjedhje. Por, me rëndësi është që institucionet e Kosovës janë duke vijuar organizimin e procesit zgjedhor ashtu siç është më së miri. Jam i bindur që i gjithë ky proces do të përfundojë i qetë, i suksesshëm, duke tejkaluar edhe problemet të cilat i përmenda", ka thënë Sveçla.

Lista Serbe, partia kryesore e serbëve në Kosovë, nuk ka aplikuar që të marrë pjesë në këto zgjedhje. Në garë për kryetar të këtyre komunave janë 11 kandidatë nga katër subjekte politike, prej të cilëve vetëm dy janë të komunitetit serb. Duke folur për gjendjen e



sigurisë në veriun e banuar me shumicë serbe, Sveçla ka thënë se gjendja atje asnjëherë nuk ka qenë e mirë, por ka shtuar se tani "çështja e sigurisë në veri kurrë nuk ka qenë më e mirë, institucionet e sigurisë kurrë nuk kanë bërë punë më të mirë". Ai ka treguar se në veri ka prani të strukturave të

sigurisë "si kurrë më parë", teksa ka shtuar se Policia e Kosovës është duke zhvilluar një aksion atje. Zgjedhjet po mbahen pasi kryetarët e komunave në veri, bashkë me serbë të tjerë, në nëntor të vitit të kaluar kanë dhënë dorëheqje në shenjë kundërshtimi ndaj vendimit të

Qeverisë së Kosovës për ta nisur procesin për reregjistrimin e makinave me targa të paligjshme serbe. Zgjedhjet fillimisht ishin paraparë të mbaheshin dhjetorin e kaluar, por u anuluan për shkak se grupe qytetarësh atje shkaktuan incidente gjatë fazës së përgatitjeve.

## Zgjedhjet në veri, KQZ-ja miraton 19 qendra të votimit, 13 prej tyre alternative

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 14 PRILL - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i Kosovës (KQZ) ka miratuar listën e qendrave të votimit për zgjedhjet e jashtëzakonshme në katër komunat e banuara me shumicë serbe në veri të Kosovës. Më 23 prill do të mbahen zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar të komunave në Mitrovicë të Veriut, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq.

Në këto komuna do të hapen 19 qendra të votimit. Prej tyre, 13 do të jenë alternative apo në kontejnerë. Vendimi për këto qendra u miratua nga KQZ-ja, me tetë vota për dhe një abstenim, në mbledhjen që ky institucion ka mbajtur të premtën. "Nga 44 qendra të votimit - në të cilat zakonisht është zbatuar procesi zgjedhor në vitin 2021, 2019 dhe më herët - tetë prej tyre kanë

konfirmuar se mund t'i hapin ato. Duke u bazuar në vlerësimin e Komisionit Komunal Zgjedhor (KKZ) dhe të organeve të sigurisë është konstatuar se vetëm gjashtë qendra të votimit mund të hapen në lokacionet e zakonshme", ka theksuar Arianit Elshani, anëtar i KQZ-së nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës. Ai ka shtuar se 13 qendra të votimit do të jenë alternative ose procesi i votimeve do të zhvillohet në kontejnerë, të cilët do të sigurohen nga institucionet e tjera.

Në proceset e mëhershme zgjedhore në komunat veriore të Kosovës qytetarët kanë votuar në qendrat e votimit të cilat ishin të vendosura në shkolla. Por për zgjedhjet e 23 prillit votimi në shkolla është bërë i pamundur për shkak se ato kontrollohen nga strukturat që punojnë sipas sistemit të Serbisë i cili i kundërshton



zgjedhjet. Vendimi për zgjedhjet e jashtëzakonshme është marrë pasi kryetarët e këtyre

komunave, bashkë me serbë të tjerë, më 5 nëntor të vitit të kaluar kanë dhënë dorëheqje në shenjë kundërshtimi ndaj

vendimit të Qeverisë së Kosovës për ta nisur procesin për reregjistrimin e makinave me targa të paligjshme serbe.



# Kosova dhe Mali i Zi nënshkruajnë marrëveshje për shërbime ajrore

Kryeministri Albin Kurti ka pritur të premten në takim kryeministrin në detyrë të Malit të Zi, Dritan Abazović, me të cilin ka nënshkruar marrëveshje për shërbime ajrore në mes të Qeverisë së Kosovës dhe Qeverisë së Malit të Zi. Kjo marrëveshje është një hap sa i rëndësishëm për rregullimin e hapësirës ajrore mes dy vendeve. Ajo ofron mundësi të reja të zhvillimit të Aviacionit Civil, mundëson shkurtimin e rrugëve ajrore e të kohës së fluturimit për 15 minuta. Një kompani ajrore që ka fluturuar katër herë në ditë, me këtë marrëveshje lehtësisht mund të shtojë edhe një fluturim

**EPOKA E RE**

Mal QORRAJ

**PRISHITINË, 14 PRILL** - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka pritur të premten kryeministrin në detyrë të Malit të Zi, Dritan Abazović, i cili po qëndron në Kosovë. Ata fillimisht zhvilluan një takim tete-a-tete për ta nënshkruar pastaj marrëveshjen për shërbime ajrore në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Malit të Zi para fillimit të takimit ndërmjet dy delegacioneve në ndërtesën e qeverisë.

Në takime u bisedua për marrëdhëniet e mira fqinjësore ndërmjet dy shteteve, mundësitë e rritjes së bashkëpunimit në fushën e ekonomisë dhe investimet në infrastrukturë të përbashkët që e rritë mobilitetin dhe hap mundësitë e zhvillimit për të dy vendet. Gjithashtu, u diskutua edhe për bashkëpunimin rajonal, rëndësinë që ky bashkëpunim ka për integrimin e ekonomive, afrimin e qytetarëve dhe përshtetimin e integritit në Bashkimin Evropian. Në të njëjtën kohë kryeministri

Kurti e njoftoi kryeministrin në detyrë Abazović për zhvillimet në vend dhe për punë, arritjet dhe rezultatet e qeverisjes tashmë më shumë se dyvjeçare. Ai shprehu mirënjohjen e tij për ndihmën e Malit të Zi në kohët më të vështira për Kosovën, kur u bë strehë shpëtimi për mbi 100 mijë qytetarë të Kosovës që u dëbuan nga fushata e gjenocidit dhe spastrimit etnik nga regjimi i Millosheviqit gjatë vitit 1998-1999 dhe për marrëdhëniet shumë të mira fqinjësore. Rëndësi e veçantë e këtij takimi ishte nënshkrimi i marrëveshjes për shërbime ajrore në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Malit të Zi. Kjo marrëveshje është një hap sa i rëndësishëm po aq i domosdoshëm për rregullimin e hapësirës ajrore në mes dy vendeve. Ajo ofron mundësi të reja të zhvillimit të Aviacionit Civil, mundëson shkurtimin e rrugëve ajrore e të kohës së fluturimit për 15 minuta. Një kompani ajrore që ka fluturuar katër herë në ditë, me këtë marrëveshje, lehtësisht mund të shtojë edhe një fluturim. Pastaj,

zvogëlon emetimin e gazrave të dëmshme si dhe ul koston e fluturimeve të cilat ndikojnë në çmim të biletave për udhëtarët. Kryeministri teksa uroi qytetarët për marrëveshjen e sotme, duke thënë sesi dy shtete nënshkruese të Marrëveshjes për Hapësirën e Përbashkët Evropiane të Aviacionit - HPEA, me marrëveshjen e nënshkruar sot hapet mundësia për shfrytëzimin e lirive të fluturimeve për kompanitë ajrore.

Krahas nënshkrimit të marrëveshjes ata biseduan edhe për projektet e përbashkëta sikurse ai për lehtësimin e kalimit në pikat kufitare te qytetarëve të Republikës së Kosovës gjatë sezonit turistik, finalizimin e protokollit për qarkullimin e transportit të mallrave dhe të qytetarëve si dhe dinamizmin e zbatimit të marrëveshjes së bashkëpunimit për ndërtimin e rrugëve Deçan - Plavë dhe Pejë - Rozhajë.

Kryeministri në detyrë, Abazović, e falënderoi kryeministrin Kurti për pritjen siç e quajti ai të jashtëzakonshme, duke shprehur bindjen se Mali i Zi dhe Kosova janë duke dhënë shembullin rajonal se si duhet të bashkëpunohet.

**Kurti dhe Abazović në konferencë për medie: Politika zyrtare e Malit të Zi karshi Kosovës nuk do të ndryshojë**

Pas takimit dhe nënshkrimit të marrëveshjes ata mbajtën edhe një konferencë për medie. Kurti tha se biseduan për marrëdhëniet e mira fqinjësore mes dy shteteve tona. Mundësitë e rritjes së

bashkëpunimit në fushën e ekonomisë dhe investimet në infrastrukturë të përbashkët që e rritë mobilitetin dhe hap mundësitë e zhvillimit për të dy vendet tona ishin në fokus të këtij bashkëpunimi. "Mali i Zi e njohu pavarësinë e Kosovës që në vitin e shpalljes në 2008-n dhe sot punojmë ngushtë si dy shtete fqinje për ta promovuar paqen, sigurinë dhe prosperitetin në rajonin tonë. Përtej marrëdhënieve të mira ndërshtetërore kemi ndërtuar edhe raporte të mira ndërmjetore. Jemi mirënjohës që në kohët më të vështira, Mali i Zi u bë strehë shpëtimi për mbi 100 mijë qytetarë të Kosovës që u dëbuan nga fushata e gjenocidit dhe spastrimit etnik nga regjimi i Millosheviqit gjatë vitit 1998-1999. Qytete të shumta si Rozhaja, Ulqini, Plava e Gucia, i hapën dyert dhe zemrat e u përkujdesen duke i strehuar në shtëpitë e tyre e në tendat të cilat u ngritën atje, refugjatët nga Kosova. Shteti dhe qytetarët e Kosovës janë mirënjohës dhe nuk do të harrojmë asnjëherë mikpritjen dhe solidaritetin. Sot qytetarët e Kosovës janë jo vetëm pushues e vizitorë në bregdetin e qyteteve të Malit të Zi, por edhe investitorë të rëndësishëm të cilët i kontribuojnë ndërlidhjes ekonomike mes dy vendeve tona", ka theksuar Kurti.

Ai ka shtuar se në vitin e fundit ka rritje të shkëmbimit tregtar me Malin e Zi. "Krahasuar me vitin 2021 në vitin 2022, eksportet e Kosovës në Mal të Zi janë rritur për 55 për qind. Gjatë vitit 2022 mbi gjysmë milion hyrje-dalje të qytetarëve janë regjistruar në pikat kufitare me Malin e Zi. Natyrisht, pa llogaritur këtu hyrjet përmes Shqipërisë, ku dihet që një pjesë e mirë e

qytetarëve para se të vijnë në Mal të Zi kalojnë nëpër Shqipëri. Biseduam edhe për bashkëpunimin rajonal, rëndësinë që ky bashkëpunim ka për integrimin e ekonomive tona, afrimin e qytetarëve dhe përshtetimin e integritit në Bashkimin Evropian. Na gëzon fakti që Mali i Zi ka ratifikuar tri marrëveshjet e mobilitetit në Tregun e Përbashkët Rajonal në kuadër të Procesit të Berlinit. Rregullat e Bashkimit Evropian, avancimi i demokracisë e i sundimit të ligjit dhe forcimi i aleancës transatlantike janë qëndrim, qëllim e përkushtim i Republikës së Kosovës në bashkëpunimin rajonal", ka theksuar Kurti.

Abazović në konferencën për medie ka thënë se kjo marrëveshje është në kuadër të disa projekteve të dy qeverive, që synojnë ta përmirësojnë atmosferën rajonale të bashkëpunimit. "Ideja jonë ishte që të krijojmë një qasje më të lehtë për qytetarët e të dy vendeve. Nëse krijojmë një mobilitet, një qasje më të lehtë, edhe shkëmbimi i mallrave, njerëzve dhe bizneseve do të jetë shumë më intensiv dhe kjo do të krijojë një atmosferë shumë më të mirë rajonale", tha Abazović, duke shtuar se në takim me Kurtin kanë biseduar edhe për projekte të tjera infrastrukturore, që do ta përmirësonin lidhjen mes dy shteteve.

Abazović ka theksuar se shteti i tij do ta përkrahë Kosovën në aplikimet për anëtarësim në organizata dhe mekanizma ndërkombëtarë dhe ka theksuar se, pavarësisht se ka pasur "disa procese politike" në shtetin e tij, politika zyrtare e Malit të Zi karshi Kosovës nuk do të ndryshojë.

## Xhaçka takohet me kryediplomatin spanjoll: Duhet angazhim konstruktiv për Kosovën

Prishtinë, 14 prill - Ministrja për Evropën dhe Punët e Jashtme të Shqipërisë, Olta Xhaçka, ka pritur në një takim homologun spanjoll Jose Manuel Albares Bueno, vizita e të cilit i paraprin marrjes së Presidencës së BE-së nga Spanja në gjysmën e dytë të vitit. Me këtë rast, kryediplomatja shqiptare ka thënë se duhet të ketë një angazhim sa më i gjerë e sa më konstruktiv për anëtarësimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare.

Në konferencën e përbashkët për medie pas takimit, Xhaçka ka bërë me dije se pjesë e diskutimeve me homologun spanjoll ishte edhe çështja e Kosovës e cila merr një rëndësi të veçantë, duke qenë një hallkë themelore për stabilitetin dhe sigurinë e Ballkanit. "Shqipëria është mirënjohëse për angazhimin e Bashkimit Evropian dhe partnerëve tanë amerikanë për arritjen e marrëveshjes për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë. Ne shpresojmë që marrëveshja do të zbatohet në një kohë sa më të shkurtër, pasi kjo do të kishte ndikim shumë pozitiv për stabilitetin, por edhe bashkëpunimin rajonal, sigurisht do të hapë edhe një perspektivë të re për një zgjidhje finale në mes të Kosovës dhe Serbisë", ka thënë Xhaçka.

Më tutje, ajo ka thënë se është në të mirën e vet Bashkimit Evropian që të ketë një

angazhim më të gjerë rreth anëtarësimit të Kosovës në organizata ndërkombëtare. "Besojmë se është në të mirën e rajonit dhe të vet Bashkimit Evropian që me Kosovën të ketë një angazhim sa më të gjerë dhe më konstruktiv, përfshirë edhe anëtarësimin e saj në organizata ndërkombëtare për të shmangur një izolim që do të kishte pasoja jo vetëm për Kosovën, por për të gjithë ne", ka thënë ministrja shqiptare.

Ndërsa ministri i Spanjës, Jose Manuel Albares Bueno, vendi i të cilit është në grupin e pesë vendeve të BE-së që nuk e ka njohur Kosovën, nuk ka pëlqyer të ndalet shumë në çështjen e vendit tonë. Ai ka përmendur shkurt se marrëdhëniet në mes të Kosovës dhe Serbisë ishin pjesë e diskutimit, por ka premtuar se Spanja do të mbështetë Shqipërinë në procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian. "Gjatë presidencës spanjolle të Bashkimit Evropian ne do të mbështetim progresin e Shqipërisë në procesin e anëtarësimit. Mbështetja jonë për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian do të jetë shumë e aktive gjatë gjashtëmuajorit që Spanja do të ketë presidencën e BE-së. Marrëdhënia në mes të Shqipërisë me Ballkanin dhe BE-së është tema që kemi folur me ministren. Gjithashtu, folëm për marrëdhëniet e Kosovës me Serbinë", ka thënë kryediplomati spanjoll.



Krejt në fund ai ka bërë me dije se do të organizohet një takim në rang kryeministrash në mes të Shqipërisë dhe Spanjës për të forcuar më tej bashkëpunimin në fusha të ndryshme. "Në këto momente ndajmë shumë vlera të përbashkëta të cilat sa i përket kartës së Kombeve të Bashkuara për paqen, luftën

kundër terrorizmit, dhunës ekstreme dhe të drejtat e grave. Do ta takoj kryeministrin Edi Rama dhe do t'ia përcjell këto mesazhe në të njëjtën formë siç ia përcolla ministres dhe si do ta organizojmë mbështetjen ndaj Shqipërisë gjatë Presidencës spanjolle. Gjithashtu, do të organizojmë një takim në rang

kryeministrash mes të dy vendeve që të na ndihmojë për të forcuar këtë rrugë të përbashkët që ne kemi marrë", tha ai.

Shqipëria dhe Spanja nënshkruan edhe një memorandum bashkëpunimi për arritjen e një koordinimi sa më të mirë të punës për çështjet e integritit evropian.

## Shqipëria nuk do ta ekstradojë rusen e akuzuar për spiunazh

TIRANË, 14 PRILL - Shtetasja ruse Svetlana Timofeeva, e akuzuar për spiunazh nga autoritetet shqiptare, nuk do të ekstradohet në Rusi. Gjykata e Elbasanit vendosi ta marrë parasysh kërkesën e saj për mosekstradim.

Vetë shtetasja ruse nuk ka bërë asnjë deklaratë gjatë seancës gjyqësore, ndërsa avokati i saj mbrojtës mirëpriti vendimin. "Ishte vendimi i duhur, i bazuar në ligj. Nëse kjo shtetase do të ekstradohej në Rusi do të përndiqej, do t'i rrezikohej jeta, pasi dihet qëndrimi i saj kundër regjimit të [presidentit rus, Vladimir] Putinit", tha Fatmir Lushi, avokat mbrojtës i shtetasës ruse.

Svetlana Timofeeva, 33 vjeçe nga Rusia, u arrestua më 20 gusht të vitit 2022 së bashku me dy shtetas të tjerë, Mikhail Zorin, 23 vjeç nga Rusia, dhe Fedir Aplatov nga Ukraina, pasi tentuan të hynin në ambientet e uzinës së armëve në Gramsh dhe hodhën sprej neuroparalizues ndaj dy

ushtarëve që po e ruanin këtë objekt ushtarak. Ajo po mbahet në paraburgim në burgun e grave në Tiranë, ndërsa çështja ndaj saj gjykohej në Gjykatën e Elbasanit, pasi zona ku ndodhi ngjarja, Gramshi, përfshihet në këtë qark.

Në dhjetor të vitit 2022 autoritetet ruse dorëzuan pranë Ministrisë së Drejtësisë në Shqipëri kërkesën për ekstradim të 33-vjeçares, ndaj së cilës është lëshuar një urdhër-arrestim, duke e akuzuar se në mënyrë të paligjshme ka siguruar informacion të klasifikuar.

Kërkesa më pas iu përcoll Gjykatës së Elbasanit dhe, pasi gjykata dëgjoi pretendimet e mbrojtjes së Timofeevës, edhe Prokuroria u tërhoq nga kërkesa e saj për ekstradim, ndaj dhe vendimi i Gjykatës së Elbasanit ishte i pritshëm.

Nuk ka ende një vendim për kërkesën për azil që avokati mbrojtës i shtetasës ruse i ka drejtuar Drejtorisë Rajonale të



Kufirit dhe Migracionit, Tiranë. Kërkesa u bë më 10 mars, rreth tre muaj pasi Moskë kërkoj ekstradim të saj. "Nëse

kthehem në Federatën Ruse do të persekutohem për shkak të bindjeve të mia politike", pretendoi 33-vjeçarja ruse.

Avokati i saj mbrojtës, Isuf Shehu, theksoi se kjo shtetase ruse mund të persekutohet në shtetin e saj.

## Mbahet tryeza “Nga politika në praktikë: Transformimi i arsimit përmes mësimit digjital”

PRISHTINË, 14 PRILL - Të premten në kryeqytet është mbajtur tryeza me temën “Nga politika në praktikë: Transformimi i arsimit përmes mësimit digjital”, e organizuar nga Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe e Inovacionit në bashkëpunim me Zyrën e UNICEF-it në Kosovë dhe Bashkimin Evropian.

Kryeministri Albin Kurti në fjalën e tij në këtë tryezë ka theksuar se nëse do të veçonim një sektor, që ka rol fundamental në zhvillimin socio-ekonomik të vendit tonë dhe që mundëson përparimin në të gjithë sektorët e tjerë, padyshim që është arsimit. Ai ka thënë se me miratimin e Strategjisë së re të Arsimit 2022-2026 për herë të parë digjitalizimi në arsim konsiderohet si një nga pesë shtyllat e kësaj strategjie ambicioze së cilës i janë dedikuar 52 milionë euro dhe që siguron një qasjeje

gjithëpërfshirëse ndaj digjitalizimit në arsim dhe adresimin e të gjitha aspekteve të këtij transformimi.

Për ta përmirësuar qasjen në mësimin digjital, Kurti ka thënë se shkollat kanë nevojë për lidhje në internet si dhe për pajisje elektronike si për mësuesit ashtu edhe për nxënësit.

Kryeministri Kurti nënvizoi se përmes projektit për Ekonominë Digjitale të Kosovës (KODE) qeveria, me mbështetjen e fondeve të Bankës Botërore, ka arritur që 100 për qind, të gjitha vendbanimet në Kosovë, përfshirë zonat e thella rurale, të kenë qasje në internet brezgjere. Ai ka shtuar se digjitalizimi ka potencialin ta revolucionarizojë mënyrën në të cilën jepet mësimi. “Me përdorimin e teknologjisë mësuesit mund të krijojnë dhe të ofrojnë njësi mësimore, ta japin dhe të bëjnë vlerësimin e



detyrave dhe të komunikojnë me nxënësit në mënyrë më efektive. Kjo mund të lirojë më shumë kohë për ata që të përqendrohen në aspektet më kritike të

mësimdhënies, siç janë ofrimi i mbështetjes dhe inpleteve individuale për nxënësit. Megjithatë, për të qenë në gjendje ta përdorin teknologjinë në

procesin e mësimdhënies, mësuesit dhe stafi tjetër arsimor kanë nevojë për kompetencë dhe aftësi të reja”, ka theksuar Kurti.

## Një muaj paraburgim për tre të dyshuarit për sulmin ndaj gazetarit Syla

PRISHTINË, 14 PRILL - Gjykata Themelore në Prishtinë ka caktuar masën e paraburgimit për një muaj ndaj tre të pandehurve me inicialet L. D., K. H. dhe O. H. për shkak të dyshimit të bazuar se kanë kryer veprën penale “Nxitja e përçarjes dhe mosdurimit”, sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Tre të pandehurit dyshohen për sulmin ndaj gazetarit Valon Syla më 11 prill.

Masa e paraburgimit për tre të dyshuarit nga gjykata është caktuar me kërkesën e Prokurorisë Speciale të Kosovës.

Gjykata vlerësoi se ekzistojnë arsyet ligjore për caktimin e paraburgimit për tre të pandehurit, sepse “ekziston dyshimi i bazuar se të pandehurit kanë kryer veprën penale për të cilën dyshohen” dhe se ekziston rreziku se mund të arratisen, t'i shmangen ndjekjes penale. “Të pandehurit, nëse do të mbeten në liri, mund ta pengojnë rrjedhën e procedurës penale, duke ndikuar edhe në dëshmitarët si dhe mund ta përsëritin veprën penale”, thuhet në komunikatën e Gjykatës Themelore të Prishtinës.

Syla ishte sulmuar më 11 prill nga

tre persona në lagjen Bregu i Diellit në Prishtinë. Një ditë pas sulmit, Syla në “Facebook” ka shkruar se është sulmuar për shkak të disa postimeve kritike të tij për disa udhëheqës fetarë.

Në reagimin e tij, ndër të tjera, Syla ka thënë se “fjala është e lirë” dhe se “të gjithë ata që predikojnë kundër lirive, nuk janë as për paqe e as për liri”.

Sulmi fizik ndaj gazetarit Valon Syla e ka çuar në dhjetë numrin e rasteve të dhunës dhe kërcënimeve që ka regjistruar Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK) deri më tani këtë vit.



## Fillojnë vizitat sistematike mjekësore për të gjithë nxënësit e shkollave në Mitrovicë



MITROVICË, 14 PRILL - Drejtoria për Shëndetësi ka filluar zbatimin e projektit i cili ka të bëjë me vizitat sistematike mjekësore për të gjithë nxënësit e shkollave të komunës së Mitrovicës. Me këtë rast, ekipet mjekësore të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare “Dr. Nexhat Çuni” fillimisht kanë kryer kontrolle mjekësore te nxënësit e shkollave të mesme të larta; Gjimnazi “Frang Bardhi”,

ShMLM “Dr. Xheladin Deda”, ShMLE “Hasan Prishtina” si dhe Shkollën e Muzikës “Tefta Tashko”.

Drejtori i Drejtorisë për Shëndetësi, dr. Fahri Shabani, lidhur me zbatimin e këtij projekti, ka thënë se çdo gjë ka filluar sipas planit dhe se vizitat patën mbarëvajtje të mirë. Ai, po ashtu, ka theksuar se gjatë këtyre vizitave është vërejtur një bashkëpunim i mirë në mes të

menaxhmentit të QKMF-së, ekipeve mjekësore, stafit dhe nxënësve të shkollave, ku ka shprehur bindjen që ky nivel i lartë i bashkëpunimit dhe kjo frymë motivuese do të vazhdojë deri në fund të projektit.

Vlen të potencohet se ky projekt i Drejtorisë për Shëndetësi do t'i përfshijë të gjitha shkollat fillore, të mesme të ulëta dhe të mesme të larta në komunën e Mitrovicës.

## Klinika e Endokrinologjisë rrit performancën e punës

PRISHTINË, 14 PRILL - Klinika e Endokrinologjisë e Qendrës Klinike dhe Universitare e Kosovës ka rritur performancën e punës. Bazuar në raportin e punës të tremujorit të parë të vitit 2023, vërehet rritje e dukshme e vëllimit të punës.

Për këtë periudhë kohore ka pasur gjithsej 210 pacientë të shtrirë (rritje 15 për qind), 4 315 vizita ambulatore (rritje 31 për qind), 825 konsultime specialiste (rritje 27 për qind). Në këtë klinikë janë kryer edhe 960 ultrasonografi të tiroides (rritje 34 për qind),

210 punctione aspirative të nodujve në tiroide (FNAB) (rritje 28 për qind) gjatë të cilave janë diagnostikuar kancere të tiroides dhe patologji të tjera. Janë shkurtuar ditët e qëndrimit në klinikë për 23 për qind.



# Marsh në Prishtinë në mbështetje të të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës

Me slogane "Bëhu zëri im" dhe "Jemi me ju" dhjetëra qytetarë kanë marshuar në sheshet kryesore të Prishtinës drejt memorialit "Heroinat", dedikuar të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës së fundit në Kosovë më 1998-'99

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 14 PRILL - Në Ditën e të Mbijetuarve të Dhunës Seksuale gjatë luftës së fundit në Kosovë në Prishtinë u organizua një marsh mbështetës për këtë kategori të shoqërisë. Me slogane "Bëhu zëri im" dhe "Jemi me ju" dhjetëra qytetarë kanë marshuar në sheshet kryesore të Prishtinës drejt memorialit "Heroinat" dedikuar të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës së fundit në Kosovë më 1998-'99. Në marsh morën pjesë edhe dy të

mbijetuar të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë, që kanë folur publikisht për rastet e tyre, Vasfije Krasniqi-Goodman dhe Shyhrete Tahiri-Sulimani. Krasniqi-Goodman tha se 14 prilli i vitit 1998 ka qenë dita më e tmerrshme e jetës së saj, pasi atë ditë ajo u përdhunua nga forcat serbe. "Sot unë këtë ditë dua ta shndërroj në forcë, në guxim, në kurajë, t'u jap forcë viktimave që zëri ynë të dëgjohej në tërë botën se çfarë ka bërë Serbia në Kosovë gjatë luftës më 1998-'99", tha ajo para të pranishmëve që u mbledhën te memoriali

"Heroinat".

Ndërkaq Tahiri-Sulimani tha se me shpalljen e 14 Prillit Ditë për të Mbijetuarit e Dhunës Seksuale gjatë luftës në Kosovë, kjo ditë tashmë është shndërruar në "ditë historike" për t'i nderuar vuajtjet që kanë kaluar të mbijetuarit e këtij krimi. "Në këtë muaj të vitit 1999 jeta, jo vetëm e imja, por e 20 mijë kosovarëve u ndryshua. Jam shumë krenare që shoh shumë të rinj e të reja këtu sot. E di se këta do të luftojnë gjithmonë për ne dhe nuk do të lënë që të na harrojnë", tha ajo.

Feride Rushiti nga Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës tha se 14 prilli do të shërbejë si kujtesë kolektive për krimin e përdhunimit që është kryer ndaj mijëra personave në Kosovë gjatë

luftës. Ajo tha se motoja e qendrës që udhëheq këtë vit është "Të rinjtë mbështetin të mbijetuarit e dhunës seksuale", teksa shtoi se shënimi i kësaj dite duhet të shërbejë edhe për edukimin e gjeneratave të reja.

Ndërkaq ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, tha se institucionet dhe qytetarët nuk duhet të lejojnë "që këto krime të harrohen apo heshtën", duke shtuar se e gjithë shoqëria duhet ta luftojë stigmën. Ky marsh është organizuar nga Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës dhe Zyra e Presidencës të Kosovës.

Që nga viti 2014 në Kosovë përmes legjislacionit njihet statusi i viktimës së dhunës seksuale të luftës të personave të përdhunuar gjatë luftës. Ata gëzojnë një

pension prej rreth 230 eurosh në muaj. Së fundi, afati për të aplikuar për njohjen e këtij statusi është shtyrë edhe për dy vjet të tjera, deri më 2025. Deri më tani këtë status e kanë gjithsej 1 451 persona.

Numri i saktë i viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë nuk dihet. Sipas një raporti të Qendrës Amerikane për Kontrollimin dhe Parandalimin e Sëmundjeve, kjo shifër arrin deri në 20 mijë. Në Kosovë për herë të parë këtë vit më 14 prill shënohet Dita e të Mbijetuarve të Dhunës Seksuale gjatë luftës së fundit. Kjo ditë, sipas autoriteteve, është shpallur për "ta njohur dhimbjen" e të gjithë të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës dhe për t'i kontribuar kujtesës kolektive.



## Kurti me ministra nderon viktimat dhe të mbijetuarit e dhunës seksuale gjatë luftës

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 14 PRILL - Në Ditën Memoriale të të Mbijetuarve të Dhunës Seksuale gjatë luftës së fundit në Kosovë, të shpallur këtë vit nga qeveria, kryeministri Albin Kurti ka nderuar viktimat dhe të mbijetuarit e dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë. Me homazhe te memoriali "Heroinat", kryeministri Kurti përkujtoi viktimat e dhunës seksuale, të cilat nuk janë më në mesin tonë, si dhe nderoi të mbijetuarat e të mbijetuarit për forcën e tyre të pashembullt. Kurti së bashku me ministrën e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, vendosi lule para memorialit, i cili përkujton mijëra gra dhe vajza, burra dhe djem, viktime e të mbijetuar të dhunës seksuale, që është përdorur si armë lufte nga forcat e okupatorit serb në luftën e fundit në Kosovë. Në homazhe morën pjesë edhe

ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, ministrja e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, ministrja e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Rozeta Hajdari, ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Liburn Aliu, drejtuesja e grupit parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje!, Mimoza Kusari-Lila, kryeshefe ekzekutive e Agjencisë për Barazi Gjinore në Zyrën e Kryeministrit, Edi Gusia, kryetare e Komisionit Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të personave të dhunuar gjatë Luftës në Kosovë, Leonora Selmani, si dhe përfaqësues të tjerë të institucioneve.

Në mbledhjen e 138, të mbajtur më 12 prill 2023, Qeveria e Republikës së Kosovës, në bashkërendim me presidenten e Republikës së Kosovës, ka shpallur datën 14 prill si Ditë Memoriale e të Mbijetuarve të Dhunës Seksuale Gjatë Luftës së Fundit në Kosovë.



## KRM "Pastrimi" bëhet me kryeshef të ri

PRISHTINË, 14 PRILL - Kryeshefi ekzekutiv i KRM "Pastrimi" Sh. A., Prishtinë, Petrit Reçica, ka pranuar pozitën në këtë ndërmarrje nga ish-ushtresja e detyrës, Fazile Haziri-Maloku. Me këtë rast, kryeshefi i ri i KRM "Pastrimi", Petrit Reçica, ka thënë se ndërmarrja është e rëndësishme për vendin dhe qytetarët dhe synimi i tij është t'i çojë përpara projektet në të

mirë të kompanisë rajonale, punëtorëve dhe shërbimeve për qytetarë. "Sot për së afërmi u njoftova me punën që është bërë në këtë ndërmarrje nga ushtresja e deritanishme znj. Haziri-Maloku. Falënderoj secilin për punën e deritanishme, e që do ta vazhdojmë së bashku me projekte të reja që kanë për synim rritjen dhe fuqizimin e

ndërmarrjes 'Pastrimi'", ka deklaruar Reçica. Kryeshefi ekzekutiv i KRM "Pastrimi", Petrit Reçica, u njoftua me punonjësit dhe zyrtarët lidhur me punën dhe veprimtaritë e secilit departament brenda kompanisë rajonale, për çka i falënderoi dhe premtoi bashkëpunim me secilin prej tyre.



## Ruajtja e cilësisë së lartë në auditim, prioritet për institucionet supreme të auditimit

PRISHTINË, 14 PRILL - Përfaqësuesit e Zyrës Kombëtare të Auditimit të Kosovës të enjten kanë marrë pjesë në webinarin me temën "Menaxhimi i cilësisë për institucionet supreme të auditimit" të organizuar nga "Sigma" në kuadër të Rrjetit të Institucioneve Supreme të Auditimit të vendeve candidate dhe candidate të mundshme për Bashkimin Evropian dhe Gjykatës Evropiane të Auditorëve. Qëllimi i këtij webinarit ishte


rritja e vëmendjes së ISA-ve të Rrjetit për ndryshimin e standardeve të menaxhimit të cilësisë dhe rëndësia e tyre; shkëmbimi i përvojave - mësimet e nxjerra nga ISA-të rreth menaxhimit të cilësisë, sfidat me të cilat përballen, planet e ardhshme si dhe pritshmëritë për standardet e rishikuara. Drejtori i Departamentit për Sigurimin e Cilësisë në Zyrën Kombëtare të Auditimit, Fitim Haliti, duke folur për procesin e

menaxhimit të cilësisë, ka treguar se Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë, i cili përfshinë edhe Kontrollin e Cilësisë dhe Sigurinë e Cilësisë, ka të integruar të gjitha elementet e Kontrollit të Cilësisë të përcaktuara në SNISA 140 si: menaxhimi i burimeve njerëzore, kryerja e auditimeve, marrëdhëniet me palët e interesit, përmirësimi i vazhdueshëm, kërkesat etike dhe monitorimi. Haliti ka treguar se Departamenti për Sigurimin e

Cilësisë është përgjegjës për sigurimin e vazhdueshëm të cilësisë në auditim duke u kujdesur që procedurat e kontrollit të cilësisë janë duke funksionuar në mënyrë efektive si dhe siguron Auditorin e Përgjithshëm se auditimet janë kryer në përputhje me SNISA-të, kurse sa iu përket pritjeve nga rishikimi i SNISA 140 ai ka thënë se fokusi është që të ofrohen udhëzime të qarta për ndërtimin e Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë dhe

Dokumentimin e Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë. ISSAI 140 ndihmon Institucionet Supreme të Auditimit që të hartojnë një sistem të kontrollit të cilësisë i cili është i përshtatshëm për mandatin dhe rrethanat e tyre dhe që u përgjigjet rreziqeve të tyre për cilësinë. Aktualisht ISSAI 140 është duke u rishikuar dhe objektivi i këtij procesi është përditësimi që përmban parimet bazë dhe kërkesat kryesore.

Zoom Meeting



## Sakip Imeri dhe Safet Gerxhaliu themelojnë kompaninë EK-Consulting

PRISHTINË, 14 PRILL - Sakip Imeri dhe Safet Gerxhaliu, ekspertë me përvojë të gjatë profesionale dhe menaxheriale në fushat ekonomike, në sektorin publik dhe privat kanë themeluar kompaninë këshilluese biznesore EK-Consulting. Kjo kompani do të merret me këshilla biznesore; trajnime edukative dhe profesionale në sektorin privat; këshilla

menaxheriale për biznese dhe individë; hulumtime dhe analiza sektoriale të tregut; hartim të planeve strategjike dhe operative; konsulencë për institucionet publike; konsulencë për integrimet euroatlantike; shërbime ligjore, edukim dhe shërbime taksimi (këshilla tatimore e doganore; ndërmjetësim për punësim; menaxhim të burimeve

njerëzore dhe edukim për profesionistët e rinj). Në mënyrë të veçantë, EK-Consulting ofron organizimin e ngjarjeve promovuese për bizneset vendore dhe ndërkombëtare, në formën e takimeve B2B, B2G, B2C me qëllim të krijimit të partnershipeve dhe promovimin e investimeve të huaja direkte në Kosovë.

**EK consulting**  
EKONOMIA E KOSOVËS

**FINEX**  
financial expert group





# Nëse Rusia ka të ardhme, duhet të bëhet shtet tjetër

Autori rus në ekzil, Sergei Lebedev, rrëfen se si karriera në gjeologji e shtyu të gërmonte në tmerret e fshehura të atdheut të vet – për një përmbledhje të re tregimesh

Intervistoi: **Guy CHAZAN** /  
The Financial Times  
Përktheu: **Agron SHALA**

Kur e pyes shkrimtarin Sergei Lebedev se si ndihet për pushtimin e Ukrainës nga vendi i vet, tiparet e tij marrin një pamje me ngjyra të fajt. “Çfarë ndjej? Tmerr dhe turp”, thotë ai. “Më vjen turp t’i shikoj ukrainasit në sy, turp sepse nuk mund të bëj asgjë për ta ndaluar këtë”.

Ndjenja zgjerohet te njerëzit e vet, te shtresat e mesme të kulturuar ruse. “Më vjen turp që ne nuk mund ta hapim gojën, e lëre më ta rrëzojmë atë”. Me “atë” ai e nënkupton Vladimir Putinin, njeriun që e nisi këtë luftë. Ai është kopuku i bisedës sonë dy-orëshe, gjatë një dreke, është fantazma i cili te rrëfimet e Lebedevit i mishëron të gjitha kthesat e gabuara që ka marrë Rusia gjatë 30 vjetëve të fundit.

Një nga shkrimtarët më të shquar bashkëkohorë të Rosisë, Lebedevi, 41 vjeç, është çmuar për një seri romanesh që janë pasqyrë e së kaluarës shkatërrimtare të Rosisë. Si ish-gjeolog, ai i heq shtresat e thella të historisë së shekullit XX të vendit të vet, shtresat e traumave të fshehura nga një fushatë e harrësive që miratohet nga shteti. Siç shkruan ai në parathënien e përmbledhjes së tij me tregime, E kaluara e tashme: Titani dhe kronikat e tjera, që botohet në ShBA në këtë muaj: “Gjatë gjithë ekzistencës së vet, shteti sovjetik i shkatërroi njerëzit dhe e shkatërroi çdo kujtim të shkatërrimit”.

Takohemi në një restorant në Potsdam, një qytet jashtë Berlinit që ka qenë shtëpia e Lebedevit për katër vjetet e fundit. Në ditët e para paramendonte se po lëviz pa probleme midis Moskës – qytetit të tij të lindjes – dhe Perëndimit. Por, lufta në Ukrainë i ka tretur të gjitha mendimet për t’u kthyer në Rusi. “Tani nuk është në radarin tim”, thotë ai.

Potsdamii është vend i pëlqyeshëm për shkrimtarin e fiksuar pas historisë. Shtëpia e tij është afër rrugës së Murit të Berlinit, vijës së parë të frontit mes Lindjes dhe Perëndimit gjatë epokës së Luftës së Ftohtë. Aty pranë ka ende hapësira boshe që ta kujtojnë atë vijë të keqe të demarkacionit. “Këtu jeni afër historisë, me të shkuarën që tani është ringjallur nga vdekja dhe që po na ndjek”, thotë ai.

Imazhi është therës dhe ma kujton njërin prej tregimeve të shkurtra të Lebedevit, Nata sot është e ndritshme, pjesë e përmbledhjes së re që në anglisht është përkthyer nga Antonina W Bouis. Ngjarja e e vendosur në fund të viteve 1980, përshkruan ish-të burgosurit e Gulagut – “të tejdukshëm si vorbullat e mjegullës” – që marshojnë drejt Kremlinit dhe rimarrin vendin e



vet mes të gjallëve. Marshuesit janë, shkruan Lebedev: “Të vdekurit nga kampet moçalore. Të burgosur që kishin prerë pemë, që kishin prerë degë, që me sharrë i kish bërë trungjet që i lëshuan në ujë. Ata u dërguan nga Lideri për ta kapërcyer pyllin e madh halor të veriut dhe vdiqën duke u bërë pjesë e tij, duke mbijetuar në rrënjë dhe në kurora, duke gjetur jetë të re në degë dhe hala”. Ndjehet si kryqëzim midis serialit televiziv me zombi, The Walking Dead, dhe të skenës në Makbethin e Shekspirin ku Mali Birnam vjen në Dansinën.

E pyes Lebedevin nëse ky procesion i fantazmave simbolizon kthimin e të shtypurve, kujtimin e krimeve të Stalinit që shpërthejnë në Moskën moderne. Ai tha se imazhi u frymëzua nga puna e tij gjeologjike në veriun e largët të Rosisë, në vitet 1990, ku u ndesh për herë të parë me gjurmët e gulagut: pasi ata u mbyllën në vitet 1950 dhe të burgosurit e tyre u liruan, kampet e punës të epokës së Stalinit thjesht u braktisën, duke u kthyer në gërmadha të peizazhit të ngrirë.

“Më ka habitur fakti se dukej se ishin dy Rusi – Rusia në të cilën jetojmë dhe Rusia e këtyre njerëzve të vdekur që veç u hodhën tutje, jashtë gjeografisë dhe historisë, përtej kujtesës dhe vetëdijes”, thotë ai. “Ata vdiqën ose u vranë atje, dhe është e përshtatshme të mos i kujtos. Dhe, gjithmonë kam ndier se ne duhet të përiqemi t’i bashkojmë këto dy Rusi”.

E kaluar e tashme është e mbushur me objektet që, si kullat e braktitura të rojeve të gulagut, veprojnë si dëshmitarë të heshtur të tmerreve të shekullit të XX.

Është ndërtesa e titulluar “Hambari”, një tregim tjetër në përmbledhje, që rri bosh dhe i mbyllur, një mister për të gjithë banorët vendas: roli i tij në vrasjen masive të hebrenjve në Rusinë e pushtuar nga nazistët, zbulohet vetëm në fund.

Ndërkohë, “Titani” rrëfen për historinë e një shkrimtari të famshëm disident, të burgosur në gulag, të cilit i lejohet të shkojë në shtëpi, por nuk i lejohet kurrë të shkruajë ndonjë tjetër roman. KGB-ja vjedh ose shkatërron çdo dorëshkrim që ai krijoi pas lirim. Lebedev thotë se ngjarja bazohet në një dosje që ai e zbuloi në arkivat e KGB-së lituaneze. “U preka nga përpjekjet e mëdha që agjencia bëri gjatë disa dekadave, për ta ndaluar këtë njeri që ta shkruajë një libër”, thotë ai. “E shfaqte një respekt të çuditshëm për letërsinë, një besim në fuqinë e fjalës ... Edhe pas vdekjes së tij ata ishin të frikësuar prej tij: vazhduan të pyesnin miqtë e tij nëse ai kishte lënë pas ndonjë dokument. Autori nuk e shkroi kurrë asnjë libër tjetër. Por, dosja voluminoze e KGB-së për të, është zëvendësuar për këtë, për një libër për të dhe për gjërat që ai bëri, si e çoi jetën e vet”.

“Në mënyrë paradoksale, ata e ruajtën kujtimin e tij ashtu siç ishte në të vërtetë – dikush që nuk u dorëzua kurrë”, thotë Lebedevi. Është testament po aq ndjellës sa një roman autobiografik.

Historia sesi Lebedev u bë romancier është po aq e zymtë – dhe shpenguese. Si i ri zbuloi se burri i dytë i gjyshes së tij – një burrë disi misterioz – kishte qenë nënkolonel në sigurimin e shtetit dhe komandant i një kampi sovjetik të punës. Ai reagoi nga pafuqia dhe dëshpërimi.

“Nuk kishte rrugëdalje për mua, nuk mund ta pyesja askënd për asgjë, se të gjithë kishin vdekur”, kujton ai. “Nuk dija si të vazhdoja”. Dhe, zgjidhja ishte të shkruante një roman.

Ky roman ishte Harresa (2011), një libër që vulosi reputacionin e Lebedevit si një nga shkrimtarët e rinj më premtues të Rosisë. Ka marrë letra të panumërta nga lexuesit të cilët thanë se kjo u kishte ndihmuar që ta kuptojnë historinë familjare.

“Ata thanë se falë librit tim ishin në gjendje t’i zbulojnë sekretet e errëta të fëmijërisë dhe të rinisë”, thotë ai. “Ai i afërmi i tyre që ishte gjithmonë në mbështjellje të heshtjes – ata papritmas e kuptuan se kush ishte ai ... u zgjidh një mister i dhimbshëm.”

E kaluara dhe sekretet e saj mund të jenë tema kryesore e Lebedevit, por këtë ditë në Potsdam, biseda vazhdon të kthehet në të tashmen – dhe luftën. Për të, Putini është padyshim fajtori kryesor. Por, në sytë e tij kolegët e tij liberalë rusë mbajnë një pjesë të fajit për fatkeqësinë që i ka ndodhur Ukrainës. Ata i injoruan të gjitha shenjat paralajmëruese të Putinit, krimet e tij të luftës në Çeçeni dhe në Siri, neo-imperializmin dhe planet që ai i ushqente për fqinjët e Rosisë, duke zgjedhur në vend të kësaj që t’i shijojnë frytet e bumit ekonomik që sundimi i tij (së paku fillimisht) solli.

“Jemi përgjegjës, sepse nuk mendojmë sa duhet, nuk bëjmë sa duhet, nuk jemi sa duhet të vetëdijshëm për rreziqet”, thotë ai. “Ishim duke fjetur në timon kur presidenti ynë u kthye nga një autokrat racional dhe praktik në një maniak me bombë bërthamore”.

Putini, thotë ai, për vite me radhë

ka punuar në aventurën e tij në Ukrainë, duke e nisur “ekspeditën e tij ndëshkuese” kundër Çeçenisë në fillim të viteve 2000, duke i shuar mediat e fundit të pavarura të Rosisë, duke e çmontuar gradualisht demokracinë.


“Por, atë brezkocë ai e ziente shumë ngadalë. E gëlltiti shtypin e pavarur për më shumë se 10 vjet dhe në fund i kishte gëlltitur të gjithat”. Ndërkohë, moskovitët e arsimuar e shijuan jetën e lulëzuar kulturore të kryeqytetit, “fotografitë, poezitë dhe këngët ... dhe ata shpresonin se gjërat do të përmirësoheshin”.

Indiferenca e tyre politike, thotë ai, është bartur edhe në të tashmen. Ai është i frustruar se sa pak nga figurat kryesore kulturore në Rusi, e kanë dënuar luftën. Në këtë sfond, ai ka shumë simpati për thirrjet e ukrainasve për bojkotimin e artit dhe të letërsisë ruse.

“Ky është pikërisht momenti kur kultura, nëse është vërtet kulturë, duhet ta tregojë veten, por në Rusi thjesht nuk po e bën këtë”, thotë ai. “Tolstoi nuk heshti. Ai gjithmonë i përgjigjej asaj që ndodhte rreth tij dhe mbante një qëndrim”.

Ka të drejt. Më kujtohet dënimi i Tolstoit për luftën ruso-japoneze të vitit 1904, filozofia e tij e pacifizmit dhe e rezistencës jo të dhunshme që e frymëzoi kaq shumë Gandin në luftën kundër sundimit britanik në Indi. Kushdo që kërkon fanar moral të qëndrimit të Tolstoit në Rusinë e sotme, kot do ta kërkojë atë.

Lufta e Ukrainës është, thotë Lebedev: “Disfata e kulturës ruse. Dhe, ndoshta është humbja përfundimtare. Sepse, nëse Rusia ka ndonjë të ardhme, duhet të bëhet shtet tjetër. Një tjetër Rusi”. /Telegrafi/



Veton Zymberi, redaktor i sportit

# Dukagjini - Drita, derbi i javës në Superligën e futboll



**KLINË, 14 PRILL** - Superliga e Kosovës në futboll vazhdon në këtë fundjavë ndeshjet e javës së 29. Të shtunën do të zhvillohen tri ndeshje shumë interesante prej orës 15:00. Derbi i kësaj dite do të zhvillohet në kryeqytet. Prishtina, e cila ka 38 pikë në tabelë, renditet e pesta në tabelë, do të takohet me Ferizajin i cili ka shtatë pikë më pak dhe është dy pozita më poshtë se skuadra bardh e kaltër. Sfidë e nxehtë pritet të jetë edhe në "Liman Gegaj". Malisheva që se ka shijuar fitoren që katër ndeshje radhazi e pret në shtëpi ekipin e Gjilanit i cili ka shkuar në numrin e pesë takimeve rresht

pa fitore në Superligë. Dueli tjetër i ditës së shtunë zhvillohet në Mitrovicë. Në stadiumin "Riza Lushta" Trepça '89 e pret Klubin e Llapit. Ndeshja më e zjarrtë e kësaj xhiroje zhvillohet në Klinë. Në javën e 29 takohen Dukagjini dhe Drita. Ekipi nga Klina, pasi ka barazuar me pikë me Prishtinën, tani synim me çdo kusht e ka të vazhdojë me këtë ritëm për t'i siguruar garat evropiane. Në anën tjetër, "Intelektualët" mision e kanë vetëm fitoren pasi për momentin janë në vendin e parë në tabelë dhe kërkojnë që në fund ta fitojnë titullin kampion. Takimi që e mbyll xhiron e 29 në Superligë është

ndërmjet Drenicës dhe Ballkanit. "Shqiponjave të zeza" iu duhet fitorja pasi janë në rrezik për të rënë nga elita e futbollit kosovar për herë të parë në histori, në anën tjetër kampioni në fuqi shpreson të gabojë Drita, ndërsa vetë të fitojë në Drenicë për ta rrëmbyer kreun e tabelës.

## SUPERLIGA - Java 29

**Të shtunën takohen:**  
15:00 Prishtina - Ferizaj  
15:00 Malisheva - Gjilani  
15:00 Trepça '89 - Llapi

**Të dielën takohen:**  
15:00 Dukagjini - Drita  
15:00 Drenica - Ballkani

## SHKURT

### Më 7 maj turniri për dëshmorin Demush Mavraj

Turniri tradicional në futboll të vogël kushtuar dëshmorit të kombit Demush Mavraj do të mbahet më 7 maj. Këshilli organizativ ka bërë me dije se me rastin e 24-vjetorit të rënies heroike të dëshmorit Demush Mavraj do të mbahet turniri në futboll të vogël. Më 15 prill fillon paraqitja e ekipeve, ndërsa sistemi i lojës do të jetë 4+1. Ky turnir do të mbahet në Shkollën Fillore "Ismail Qemali" në Saradran.

### Ndërroi jetë ish-trajneri i futbollit Selatin Vokri

Ka ndërruar jetë Selatin Vokri, i cili ka dhënë kontribut të madh në zhvillimin e futbollit në Kosovë. Lajmin për vdekjen e tij e kanë dhënë familjarët e tashmë të ndjerit. Kohën e fundit Vokri ishte në gjendje jo të mirë shëndetësore. Vokri ka marrë mirënjohje nga Federata e Futbollit e Kosovës për kontributin e tij gjatë periudhave të ndryshme në futbollin e Kosovës, qysh nga koha e tij si futbollist e deri në periudhën e zhvillimit të futbollit të pavarur, e që në fund rezultoi me realizimin e objektivit për anëtarësim në UEFA.

### Përfundon sezoni për Faton Malokun

Skuadra Drita ka njoftuar se ka përfunduar sezoni për portierin Faton Maloku. Portieri i dëshmuar në futbollin e Kosovës është lënduar në ndeshjen ndaj Trepçës '89 dhe pritet të mungojë për një kohë të gjatë, ndërsa shumë shpejt pritet t'i nënshtrohet operacionit. "Portieri ynë, Faton Maloku, ka përfunduar sezonin pas lëndimit në ndeshjen e fundit kundër Trepçës '89. Ekzaminimet e fundit kanë treguar që Maloku ka këputur ligamentin ACL dhe do të jetë jashtë fushës për një kohë të gjatë. Javën që vjen pritet që Fatoni t'i nënshtrohet operimit. Klubi i dëshiron suksese në operim dhe rikuperim sa më të shpejtë! Forca Faton, të presim edhe më të fortë", ka njoftuar skuadra e Dritës.

### Marku: Mezi pres të rikthehem në ring

Boksieri shqiptar Florian Marku është duke u përgatitur intensivisht për meçin e tij të radhës, të parin për vitin 2023. Marku përmes rrjeteve sociale ka publikuar një video, ku shihet në palestër duke u stërvitur. "Ndihehem mirë pas kthimit në kamp. Me dy duart e mia në zjarr, mezi pres luftën e radhës", ka shkruar boksieri shqiptar. Florian Marku luftën e fundit e zhvilloi gjatë vitit të kaluar, ku mposhti me vendim të gjyqtarëve boksierin nga Meksika, Miguel Parra. Luftë kjo e cila ishte zhvilluar në stadiumin shqiptar "Air Albania". Marku gjatë karrierës së tij në boks ka zhvilluar 13 meçe, ka fituar në 12 (7 me nokaut) dhe ka barazuar në një luftë.

## Rahoveci pret në derbi Vushtrrinë

**PRISHTINË, 14 PRILL** - Rahoveci - Vushtrria vlerësohet kryendeshja e xhiros së 27 në Superligën A të Kosovës në Hendboll. Kjo ndeshje luhet të dielën nga ora 20:30 në palestrën "Mizahir Isma" në Rahovec. Dy xhiro para fundit të Superligës A, Rahoveci e Vushtrria, janë në garë për pozitën e tretë. Pas xhiros së 26, e treta është Vushtrria me 27

pikë. Rahoveci e mban vendin e katërt me 25 pikë. Pritet ndeshje e fortë dhe interesante deri në fund. Dy ndeshjet e tjera të xhiros së 27 janë të shtunën. Nga ora 19:00 Kastrioti e pret Besa Famgasin. Besa udhëheq me 46 pikë dhe shumë më herët e ka siguruar vendin e parë për plejof. Ndërkohë Kastrioti është i gjashti me 19 pikë, pa gjasa për të aritur në zonën e plejofit.

Skuadra pejane është favorite. Në palestrën "Minatori" në Mitrovicë nga ora 20:30 takohen Trepça e Prishtina, që kanë zhvilluar ndeshje të forta gjatë këtij kampionati. Një tjetër ndeshje e fortë pritet të shtunën mbrëma. Trepça është e dyta me 32 pikë dhe prej kësaj pozite do të startojë në plejof, ndërsa Prishtina është e pesta me 23 pikë.



## Ancelotti: Dua të vazhdoj me Realin

MADRID, 14 PRILL - Për një kohë të gjatë është përfolur se Carlo Ancelotti do të largohet në fund të sezonit nga Real Madridi dhe do t'i bashkohet kombëtares së Brazilit. Por, ditët kalojnë dhe tekniku italian me deklaratat e tij shpjegon se dëshira e tij e

vetme është ta vazhdojë aventurën me "Los Blancos", gjë për të cilën thekson se të njëjtën dëshirë ka edhe Florentino Perez, presidenti i klubit spanjoll. "Mendoj se Florentino dëshiron të vazhdojë, sepse ai ka qenë

gjithmonë shumë i dashur dhe vazhdon të jetë i tillë. Klubi është i qetë dhe jam i sigurt se do të jem këtu sezonin e ardhshëm, do ta respektojmë kontratën. Ndiem krenar për gjithçka. Deri më tani ka qenë një rikthim i suksesshëm dhe

shpresoj se mund të vazhdojë kështu, por ajo që më bën më të lumtur është të kthehem në Valdebebas çdo ditë për të punuar. Klubi më tregon shumë dashuri çdo ditë. Ndiem shumë rehat", është shprehur Ancelotti.



## Sot dhe nesër ndeshjet e dyta gjysmëfinale të 'play-off'-it



SUHAREKË, 14 PRILL - "Beteja" në gjysmëfinale të "play-off"-it vazhdon në fundjavë, ku zhvillohen ndeshjet e dyta. Në ndeshjen e parë Peja mundi Golden Eagle Yllin 85:82. Kampionët do të përpiqen ta barazojnë rezultatin, pasi një fitore e pejanëve do të afronte drejt finales. Në anën tjetër, pejanët kanë nëntë fitore radhazi nën drejtimin e Rami

Hadarit, duke mos pësuar asnjë humbje. Takimi në Therandë pritet të jetë mjaft interesant. Në anën tjetër një superpërballje pritet të dielën në Mitrovicë, ku ndeshen Trepça dhe Sigal Prishtina. Bardhkaltrit fituan duelin e parë 82:70, në një sfidë ku kishte shumë kthesa në rezultat, ndërsa atmosfera në "Minatori" pritet të

jetë e zjarrtë, ashtu si ka qenë gjatë gjithë edicionit. Sistemi i garave gjysmëfinale është 1-1-1-1-1, ndërsa në finale kualifikohet skuadra që shënon tri fitore.

**Të shtunën takohen:**  
20:30 Golden Eagle Ylli - Peja

**Të dielën takohen:**  
17:15 Trepça - Sigal Prishtina

## Më 20 prill Kosova mëson kundërshtarët e kualifikimeve për evropian

PRISHTINË, 14 PRILL - Rritja e Përfaqësueses së Kosovës në hendboll (femrat) pritet të vazhdojë në kualifikimet për Kampionatin Evropian të vitit 2024. "Euro 2024" do të mbahet prej 28 nëntorit deri më 15 dhjetor në Austri, Hungari e Zvicër. Për herë të parë në Kampionat Evropian të hendbollistëve do të paraqiten 24 ekipe kombëtare. Kosova është një prej 32 kombëtareve që do të paraqiten në kualifikime. Shorti i kualifikimeve do të tërhiqet të enjten e ardhshme, më 20 prill, nga ora 17:00. Ceremonia e shortit do të mbahet në Cyrih të Zvicrës. Pritet të formohen tetë grupe me nga katër ekipe kombëtare, ndërsa gjasë për kualifikim ka edhe nga vendi i tretë. Austria, Hungaria dhe Zvicra kualifikohen si nikoqire, ndërsa në kualifikime pritet të jenë të gjitha kombëtares e mëdha të kontinentit. Kosova arriti deri në fazën e dytë



kualifikuese për Botërorin 2023, ku u ndal nga Polonia. Deri më tani Evropiani i hendbollistëve është mbajtur me 16 kombëtare. Nga

edicioni i ardhshëm numri i Kombëtareve do të jetë 24 dhe kjo rritje ofron mundësi dukshëm më të mëdha për kualifikim.

### SHKURT

#### Nadali heq dorë edhe nga turneu i Barcelonës

Pasi vendosi të mos luajë në turneun Masters të Montekarlo, që po zhvillohet aktualisht në Principatë, tenisti spanjoll Rafael Nadal ka dhënë sot lajmin se nuk do të luajë as në turneun e Barcelonës. Një tjetër tërheqje e fituesit të 22 grand slam në karrierë, që ende nuk ka rikuperuar nga dëmtimi i pësuar në Australian Open, në janar. "Barcelona është një turne i veçantë për mua, pasi aty luaj si në shtëpinë time. Nuk jam ende gati për t'u rikthyer në fushë, ndaj nuk do të luaj aty. Do ta vazhdoj fazën time të rehabilitimit për t'u rikthyer sa më shpejt në fushë", u shpreh Rafael Nadal në një postim në rrjetet sociale.

#### Allegri: Nuk ka përfunduar asgjë

Juventusit e ka bërë një hap të madh drejt kalimit në gjysmëfinale, pasi e ka mposhtur Sporting Lisbonën (1-0). Pas ndeshjes, trajneri i "Zonjës së Vjetër", Max Allegri, ka thënë se, edhe përkundër fitores, asgjë nuk ka përfunduar rreth kualifikimit. "E dinim që Sportingu është një ekip i fortë, nuk ka përfunduar asgjë. Duhet të përgatitemi shumë mirë që të enjten të kualifikohemi në Lisbonë", ka thënë Allegri.

#### Ten Hagen pas barazimit ndaj Sevilës: Më keq se kaq nuk mund të shkonte


Manchester Unitedi ka barazuar me Sevilën (2-2). Klubi anglez ishte në epërsi prej dy golave, por spanjollët arritën ta barazonin rezultatin. Trajneri Erik Ten Hag ka thënë se me keq nuk ka si të shkonte. "Kishim ndeshjen në dorë, ishim në avantazh 2-0 dhe duhet të kishim shënuar tre ose katër gola. Ishim të pafat edhe me dëmtimet, pësuam dy autogola, më keq se kaq nuk mund të shkonte", ka thënë Ten Hag.

#### Ronaldo mund të ribashkohet me Zidanen

Nuk është vetëm Jose Mourinho një nga objektivat e skuadrës së Al Nassrit, klub ku luan edhe Cristiano Ronaldo. Sipas asaj që raporton CBC Sport, një nga objektivat e mundshëm është strategu francez Zinedine Zidane. Ronaldo më parë është stërvitur nga Zidane, ndaj dhe një ribashkim i mundshëm mund të jetë më se i mundshëm. Francezi gjithsesi ka qenë shumë selektiv për të ardhmen e tij. Nëse nuk shkon as ai dhe as Mourinho, atëherë një opsion i mundshëm është Jorge Mendes, i cili ka kontratë me Fenerbahçen deri në fundin e këtij sezoni.

#### Bayerni seriozisht mendon për transferimin e Kanes

Bayern Munchen është i interesuar për nënshkrimin e yllit të Tottenham Hotspurit, Harry Kane, këtë verë. Kapitani i Anglisë është shumë i kërkuar pas një tjetër sezoni të shkëlqyer në nivel personal me "Spurs". Kane, i cili gjithashtu shkëlqeu në Kupën e Botës "Katar 2022", nuk ka fituar asnjë trofe me "Spursin" për një tjetër sezon dhe largimi duket gjithmonë si opsion. Sipas mediumit "The Independent", Bayerni do ta rivalizojë Manchester Unitedin në garën për nënshkrimin me sulmuesin anglez. Kryetari i "Spursit", Daniel Levy, mund ta shesë futbollistin jashtë vendit para se ta shesë te një rival i Ligës Premierë.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Opština Prishtina - Municipality of Prishtina  
Gjimnazi "Sami Frashëri"

Gjimnazi "Sami Frashëri" Prishtinë  
Nr.1395/14, dt.14.04.2023

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr. 02/2016 për aktivitetet jashtëshkollore, Gjimnazi "Sami Frashëri" shpallë këtë:

### FTESË PËR OFERTË

SHML Gjimnazi "Sami Frashëri" në Komunën e Prishtinës organizon ekskursionin e maturantëve të vitit shkollor 2022/2023 për në Republikën e Shqipërisë. Ftohen operatorët ekonomikë për parashkrimin e ofertave përkatëse, duke ju përmbajtur kushteve të kësaj oferte.

#### I. Informata të përgjithshme

1. Ftesa për ofertë mbetet e hapur shtatë (7) ditë nga data e publikimit të ftesës më dt. 15.04.2023 deri më dt. 21.04.2023;
2. Ofertat e operatorëve ekonomikë duhet të përcaktojnë çmimin për nxënës, i cili përfshinë akomodimin në hotel, fjetjen, sigurinë fizike, sigurinë shëndetësore, ushqimin cilësor dhe kalorik, shërbimin mjekësor 24 orë, transportin, shpenzimet përcelëse në monumente dhe vende historike dhe çështje të tjera specifike të kontrollimit teknik dhe personelit të agjencisë të përcaktuara në kushtet e kësaj ftese për ofertë; Datat e përcaktuara (Pesë ditë mes datave 10.05.2023 deri më 20.05.2023).
3. Kohëzgjatja e ekskursionit dhe qëndrimin në Durrës do të jetë pesë (5) ditë apo katër (4) bujtje. Në ditën e pestë bëhet kthimi për në Prishtinë;
4. Numri i nxënësve maturantë që do të udhëtojnë për në Republikën e Shqipërisë do të jetë treqind e pesëdhjetë (353), përfshirë edhe personelin e shkollës;
5. Çështje të tjera specifike përcaktohen në kontratën midis autoritetit kontraktues (shkolla) dhe operatorit ekonomik (agjencitë);
6. Operatorët ekonomikë (agjencitë) duhet t'i përmbahen të gjitha obligimeve që përcaktohen me Udhëzimin Administrativ (MASHT) nr. 02/2016 për aktivitetet jashtëshkollore dhe të gjitha akteve tjera ligjore/nëligjore përkatëse.

#### II. Kushtet

1. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ketë lejen e punës;
2. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ketë certifikatën e biznesit dhe informatat përkatëse të biznesit;
3. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ketë vërtetimin tatimor nga ATK;
4. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ketë licencën sipas Ligjit mbi transportin me të drejtë qarkullimi jashtë kufijve të Republikës së Kosovës;
5. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ketë bërë kontrollimin teknik të të gjithë autobusëve sipas procedurave të përcaktuara ligjore;
6. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ketë numër të mjaftueshëm të autobusëve për nevojat e shkollës;
7. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ketë autobusët komfort dhe me klimë;
8. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ketë dokumentacionin (licencën) e agjencisë së akreditimeve të ushqimeve në vendqëndrimin e nxënësve (licenca të jetë e vërtetuar edhe nga pronari i restorantit);
9. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ketë dëshmi për shëndetin psiko-fizik të ngasësve (shoferëve) të autobusëve;
10. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të siguron përkujdesje dhe shërbime mjekësore për nxënësit gjatë tërë kohëzgjatjes së ekskursionit, diplomën dhe kontratën e punës së mjekut;
11. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të siguron dëshmi për rezervimin e hotelit në datat e caktuara me vërtetim përkatës, i cili hotel duhet të ofron siguri 24 orë për nxënësit dhe personelin përcjellës;
12. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ofron dëshmi se hoteli i rezervuar të posedon licencën për aktivitete të lira dhe argëtim për nxënësit (ballo);
13. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ofron dëshmi se hoteli i rezervuar të mos shërben pije alkoolike;
14. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ofron dëshmi se hoteli i rezervuar ka shtretër të mjaftueshëm për 340 nxënës dhe të mos sistemohen më shumë se tre/katër nxënës në dhomë;
15. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ofron dëshmi se hoteli i rezervuar ka sallën e licencuar të ushqimit dhe ofron tre (3) porcione të plota të ushqimit;
16. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ofron dëshmi se hoteli i rezervuar është i rrethuar dhe krijon siguri për nxënësit;
17. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ofron listën e ngasësve (shoferëve) të autobusëve dhe punëtorëve që do të marrin pjesë në ekskursion;
18. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ofron referime tjera organizative të ekskursioneve me maturantë;
19. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të siguron dëshmi të kushteve dhe standardeve me pamje përkatëse të hotelit të rezervuar;
20. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të siguron të dhënat e hotelit të rezervuar, emrin dhe mbiemrin e pronarit, adresën dhe numrin kontaktues të pronarit/përgjegjësve të hotelit të rezervuar;
21. Lirimi deri në tre (3) përqind (%) e numrit të pjesëmarrjes së nxënësve në ekskursion me gjendje të vështirë ekonomike, që përcaktohet nga Këshilli i Organizativ i Ekskursionit.

2

#### III. Dokumentet e kërkuara

1. Leja e punës së OE;
2. Certifikatën dhe informatat e biznesit së OE;
3. Vërtetimi tatimor nga ATK;
4. Licenca e transportit ndërkombëtar - D të OE;
5. Librezat e të gjithë autobusëve të OE;
6. Dëshmia e kontrollimit teknik të autobusëve;
7. Dëshmi të komfortit/klimës së autobusëve;
8. Licenca e agjencisë së akreditimeve të ushqimeve në vendqëndrimin e nxënësve (vërtetim nga pronari i restorantit/hotelit);
9. Certifikata shëndetësore e ngasësve (shoferëve) të autobusëve;
10. Diploma dhe Kontrata e punës së mjekut;
11. Dëshmia e rezervimit të hotelit - Vërtetim;
12. Licenca/vërtetimi i hotelit për aktivitete të lira dhe rekreative për nxënësit;
13. Vërtetimi i hotelit për mos-shërbim të pijeve alkoolike;
14. Vërtetimi i hotelit për numrin e dhomave dhe sistemimin për numrin e nxënësve për dhomë;
15. Licenca e hotelit për sallën e ushqimit në ofrimin e tre vakteve ushqimore;
16. Vërtetimi i hotelit për sigurinë e nxënësve;
17. Lista e ngasësve me licencën D për transport ndërkombëtar;
18. Dëshmi tjera organizative të ekskursioneve përkatëse;
19. Fotografi dhe dëshmi të standardeve dhe kushteve të hotelit të rezervuar;
20. Konfirmim me të dhënat e vendndodhjes së hotelit dhe të dhënat e pronarit të hotelit.
21. Deklarata për lirim nga pagesa deri në tre (3) përqind (%) e numrit të pjesëmarrjes së nxënësve në ekskursion me gjendje të vështirë ekonomike.

#### IV. Dorëzimi i dokumenteve

1. Ftesa për ofertë do të jetë e hapur shtatë (7) dita nga data e publikimit të ftesës për ofertë më 15.04.2023 deri më datën 21.04.2023;
2. Aplikimi dhe dorëzimi i dokumenteve bëhet në *zarf të mbylltur* në objektin e vjetër të Komunës të Prishtinës me protokoll zyrtar, në sportelin nr. 5, drejtuar Drejtorisë së Arsimit të Komunës të Prishtinës;
3. Dokumentet e dorëzuara nuk kthehen dhe duhet të jenë kopje të noterizuara; Të noterizuara duhet të jenë dokumentet me numër rendor një (1), dy (2), katër (4), dhe gjashtë (6).
4. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen;
5. Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave të dorëzuara bëhet nga Komisioni përkatës në Drejtorinë e Arsimit, duke respektuar kushtet dhe kriteret e përcaktuara me legjislacionin në fuqi;
6. Ofertuesi i përzgjedhur merr të gjitha obligimet e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi.

#  
3

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Visar Qenaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Bajram Curi " Romaje.

- Beko Meta shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu " Izvor " Lubinje e Epërme.

- Sadete Musa nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të shkollës fillore "Jahë Salihu" Molliq KK Gjakovë.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.



# ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

## Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

